

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

NJOFTIM

PËR

**SHPALLJE PËR REKRUTIMIN E 2 (DY) SPECIALISTËVE ME
KONTRATA TË PËRKOHSHME PUNE**

Në kuadër të zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 09.01.2025 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon të rekrutojë me kontrata të përkohshme pune (6 ore në ditë):

- 1 (një) Specialist për fushën e Protokoll-Arkiv
- 1 (një) Specialist në fushën e IT-së

 Përshkrimi i punës i specialistit në fushën e Protokoll – Arkivë

Mbështetja për sektorin e protokollit dhe arkivës fokusohet në çështje që lidhen me:

- ✓ Marrjen në dorëzim dhe shpërndarjen e postës, evidentimin dhe protokollimin e saj në regjistrat përkatës
- ✓ Mbajtjen dhe administrimin e librave e dorëzimit të shkresave të korrespondencës brenda institucionit të Avokatit të Popullit
- ✓ Përcjelljen e shkresave të ndryshme tek strukturat përkatëse të institucionit
- ✓ Mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe kujdesi për sigurimin e kushteve për organizimin dhe mirëadministrimin e dokumentacionit që ndodhet në Zyrën e Protokollit
- ✓ Shpërndarjen e dosjeve të punuara nga ekspertët në Seksionet përkatëse
- ✓ Përpunimin e dokumentave të arshivuara në arkivën e Institucionit si dhe menaxhimin e fondit arkivor
- ✓ Ndjekjen e çdo detyre tjetër të ngarkuar nga eprorët.

 Përshkrimi i punës i Specialist në fushën e IT-së

Përshkrimi i punës i specialistit do të fokusohet në çështje që lidhen me:

- ✓ Mbështetja e vazhdueshme e Sektorit të IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve.

- ✓ Mirëmbajtja e kamerave të sigurisë.
- ✓ Mirëmbajtja e aksesit hyrëse-dalëse nëpërmjet kartave të çdo punonjësi.
- ✓ Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik, administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit telefonik.
- ✓ Mirëmbajtjen e informacionit nëpërmjet programeve që ka në zotërim institucioni i Avokatit të Popullit

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve

A. Për specialistin në fushën e “Protokoll – Arkivë”

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të zotërojnë minimalisht Diplomë të nivelit “Bachelor”.
- Të kenë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi;
- Të kenë fleksibilitet, aftësi të forta adaptimi dhe aftësi për punë në ekip
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike

B. Për Specialistin në lidhje me fushën e IT-së

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të zotërojnë minimalisht Diplomë të nivelit “Bachelor”, në Shkencat Elektronike/Teknologjike/Inxhinjerike.
- Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup
- Të kenë njohuri të mira të gjuhës Angleze
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike

Orari dhe Periudha

Kandidatët fitues do të rekrutohen mbi bazën e një kontrate pune me kohë të pjesshme (6 orë në ditë), për një periudhë kohore deri më 31 dhjetor 2025.

Orari ditor i punës do të jetë nga ora 09.00 – 15.00 me fleksibilitetin që në raste urgjente dhe të domosdoshme puna të vijojë edhe përtej fashës së orarit të punës të përcaktuar më sipër.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit:

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Letër motivimi
- Curriculum Vitae (CV)
- Kopje e diplomës
- Çertifikatë, dëshmi
- Kopje e librezës së punës

- Dëshmi të gjuhës së huaj (nëse ka)
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore

Aplikimet duhet të dërgohen në rrugë elektronike në adresën:

burime.njerezore@avokatipopullit.gov.al: ose në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Institucioni i Avokatit të Popullit
Blv. "Zhan D'Ark", nr 2, Tiranë
Shqipëri

Afati

Aplikimet pranohen deri në datë 15.07 2025, ora 16:30. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumenteve vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.